

**PROJEKTI PËR KONKURRENCË LOKALE DHE
RAJONALE**

**INVESTIMET NË INFRASTRUKTURËN TURISTIKE
NË KOMUNËN E KOÇANIT**



**PLANI PËR MENAXHIMIN ME MJEDISIN
JETËSOR PËR PROJEKTIN “PARAJSA MALORE
E ÇIKLIZMIT”**

JANAR 2019

HYRJE

Projekti për Konkurrencë Lokale dhe Rajonale (PKLR) është një operacion katërvjeçar për investim, i mbështetur nga Bashkimi Evropian i cili shfrytëzon fonde nga IPA 2 të destinuar për konkurrencë dhe inovacione në Maqedoni.

Me PKLR-në do të menaxhojë Fondi Hibrid financiar (Hybrid Trust Fund) dhe që do të përbëhet nga katër komponente, që do të realizohen nga Banka Botërore (BB) dhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë. Projekti do të mundësojë mjete për investim dhe ndërtim të kapaciteteve për përkrahje të rritjes së sektorit, për investim në destinacione dhe krijim të prosperitetit në destinacione të caktuara. Në nivel rajonal dhe lokal, projekti do të përkrahë destinacione të përzgjedhura turistike në vend nëpërmjet kombinimit të ndihmës teknike për përmirësim të menaxhimit me destinacionin, për investim në infrastrukturë dhe investim në lidhshmëri dhe inovacion. Investimi do të realizohet përmes një skeme të granteve për pjesëmarrësit rajonal turistik, si për shembull komunitet, institucionet, OJQ-të dhe sektori privat.

Ky plan për menaxhim me mjedisin jetësor dhe aspektet sociale është përgaditur për aktivitetet të cilat realizohen për projektin “Parajsa malore e çiklizmit” në përputhje me Kornizën për menaxhim me mjedisin jetësor dhe aspektet sociale (KMMJ). Të gjitha aktivitetet duhet të jenë në përputhje me KMMJ-në. PMMJ paraqet një dokument për mjedisin jetësor i cili përbëhet nga përshkrimi i projektit, detajet teknike, fushëveprimin, mjedisin dhe vendndodhja, në bazë të të cilit vlerësohen rreziqet ndaj mjedisit jetësor dhe rreziqet shoqërore dhe masat për shmangien dhe lehtësimin e tyre. Zbatimi i masave për lehtësim të rreziqeve të perceptuara dhe problemeve të cilat janë përmendur në PMMJ është i domosdoshëm.

Në kuadër të aplikimit për marrjen e një granti për Projektin për Konkurrencë Lokale dhe Rajonale - "Investimet në infrastrukturën turistike dhe lidhjet në destinacione", Komuna e Koçanit ka hartuar Planin për Menaxhim me Mjedisin Jetësor për aktivitetet e mëposhtme të projektit:

1. Ndërtimi, rikonstruimi dhe përmirësimi i shtigjeve malore të çiklizmit në malet e Osogovës (Ponikva - Liqeni Gratçe - Koçani) - në gjatësi të përgjithshme prej 35 km.
2. Rikonstruimi i shtëpizës malore të Ponikvës, përfshirë furnizimin e pajisjeve.

Qëllimi kryesor i projektit është kërkesa për zhvillimin e turizmit rekreativ sportiv në pjesën lindore të Republikës së Maqedonisë. Realizimi i projektit do të kontribuojë edhe për kushte më të mira për jetesë dhe përmirësimin e zhvillimit ekonomik të komunës së Koçanit.

KOMUNA E KOÇANIT

Me ligjin për organizimin territorial të Vetëqeverisjes Lokale në Republikën e Maqedonisë (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 55/04) është themeluar komuna e Koçanit si Njësi e Vetëqeverisjes Lokale dhe është përcaktuar zona me vendbanimet që përbëjnë komunën e Koçanit. Komuna e Koçanit ndodhet në pjesën lindore të Republikës së Maqedonisë dhe me ndarjen e re territoriale të Republikës së Maqedonisë ka 38,092 banorë (sipas regjistrimit të popullsisë në vitin 2002) dhe 28 vendbanime dhe mbulon një sipërfaqe prej 382 km².

Aktivitetet kryesore të komunës së Koçanit përcaktohen me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 5/02) sipas së cilit komunat janë kompetente për kryerjen e punëve të mëposhtme:

1. Planifikimi urban (urban dhe rural)
2. Mbrojtja e mjedisit jetësor dhe natyrës
3. Zhvillimi ekonomik lokal
4. Aktivitetet komunale
5. Kultura
6. Sporti dhe rekreacioni
7. Mbrojtja sociale dhe mbrojtja e fëmijëve
8. Arsimi
9. Kujdesi shëndetësor
10. Mbrojtja dhe shpëtimi i qytetarëve dhe të mirat materiale
11. Mbrojtja nga zjarri
12. Mbikqyrja dhe
13. Çështje të tjera të përcaktuara me ligj.

Administrata komunale e Vetëqeverisjes Lokale të komunës të Koçanit është e organizuar në 5 sektore me 12 njësi edhe atë:

Spektori për punë juridike, publike dhe punë të përgjithshme:

- Njësia për punë juridike dhe të përgjithshme;
- Njësia për punë publike.

Spektori për çështje financiare:

- Njësia për koordinimin e buxhetit,
- Njësia për kontrollin e buxhetit,
- Njësia për kontabilitet dhe pagesë dhe
- Njësia për tatime, taksa dhe kompensime.

Spektori për urbanizëm, mbrojtje të mjedisit jetësor dhe çështjeve komunale:

- Njësia për urbanizëm dhe mbrojtje të mjedisit jetësor dhe
- Njësia për punë komunale

Spektori për rregullimin dhe disponimin e tokës ndërtimore:

- Njësia për rregullimin e tokës ndërtimore dhe
- Njësia për zbatimin e procedurës për disponimin e tokës ndërtimore

Spektori për planifikim dhe zhvillim:

- Njësia për ZHEL dhe bashkëpunimi ndërkufitar dhe
- Njësia e sistemeve informative të TIK dhe GEO.

Ekzistojnë edhe 4 njësi të pavarura në këtë komunë edhe atë:

- Njësia për shërbime të inspektimit,
- Njësia e Revizionit të brendshëm,

- Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore si edhe
- NJTKZ (Njësia Territoriale kundër Zjarrit) të komunës së Koçanit.

Numri i përgjithshëm i të punësuarve në komunën e Koçanit është 96 persona edhe atë: 69 nëpunës administrativë, 11 persona i përkasin stafit teknik dhe 16 punonjës në NJTKZ.

Vizioni i komunës së Koçanit

Krijimi i kushteve për rritje pozitive ekonomike në komunë në 5 vitet e ardhshme me krijimin e një sistemi për shfrytëzimin dhe menaxhimin me burimet lokale (ekonomi) i cili do të mundësojë ruajtjen e vendeve aktuale të punës dhe në të njëjtën kohë do të krijojë kushte për hapjen e vendeve të reja të punës, që është kusht themelor për përmirësimin e standardit dhe në këtë mënyrë edhe cilësinë e jetesës në komunë.

Personeli në fushën e mjedisit jetësor në komunë

Në sektorin e mjedisit jetësor në komunë punon vetëm një person për mbrojtjen e mjedisit jetësor.

KORNIZA LIGJORE

Zbatimi i të gjitha aktiviteteve të projektit nuk do të realizohet në zonat e mbrojtura. Disa nga aktivitetet e propozuara të nën-projekteve janë brenda zonës së mbrojtur të propozuar – Zonë e mbrojtur "Malet e Osogovës", por kjo zonë propozimi nuk është miratuar nga Qeveria e RM-së si zonë e mbrojtur.

Sipas legjislacionit nacional për mjedisin jetësor, është e domosdoshme të bëhet vlerësimi i ndikimit mbi mjedisin jetësor për të gjitha projektet që përfshijnë ndërtimin / rikonstruimin e shtigjeve të çiklizmit, parkingut dhe shtëpizës malore (Rregullorja për Raportet e VNMIJ-së ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 32/12)).

Në kuadër të **nën-projektit 1** - Ndërtimi, rikonstruimi dhe përmirësimi i shtigjeve malore të çiklizmit në malin e Osogovës (Ponikva – liqeni Gratçe - Koçani) me gjatësi të përgjithshme prej 35 km, janë përgatitur dy raporte mbi VNMIJ-në për shtigjet malore të çiklizmit nga Koçani (vendbanimi Baçallkuk) deri në liqenin Gratçe në gjatësi të përgjithshme prej 2.801.44 metra dhe shtigje malore për këmbësorë dhe çiklizëm nga Hoteli Gratçe deri te diga e liqenit Gratçe në një gjatësi të përgjithshme prej 520.81 metra nga kompania Impakt Vizija SHPK Shkup në muajin qershor të vitit 2016. Këto dy raporte për VNMIJ-në janë bërë nga z. Zoran Manasiev, Udhëheqës i sektorit, i autorizuar nga Kryetari i komunës së Koçanit (Aktvendim UPI nr.22-270 të datës 23.06.2017 (Aneksi 2) dhe Aktvendimi UPI nr.22- 271 të datës 23.06.2017) (Aneksi 3).

Shtigjet e tjera të çiklizmit (shtegu malor i çiklizmit Jastrebnik (nga liqeni Gratçe deri te QRS Ponikva) në gjatësi të përgjithshme prej 15.21 km, shtegu malor i çiklizmit nga Ponikva deri në digën e liqenit Gratçe në gjatësi të përgjithshme prej 14.973 km dhe shtegu malor i çiklizmit nga diga e liqenit Gratçe deri tek ujëvarat në gjatësi të përgjithshme prej 1.567 km) nuk ndodhen në zonën e mbuluar me plane të detajuara urbanistike (sipas Ligjit për ndërtim) dhe për këtë arsye raportet e VNMIJ-së për këto shtigje nuk janë hartuar.

Sipas Rregullores së raporteve të VNMJ-së ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr.32 / 12), **nën-projekti 2** - Rikonstruimi i një shtëpize malore në Ponikvë, duke përfshirë edhe furnizimin e pajisjeve, bie në Aneksin 1, Kapitulli XI, pika 2 – Kapacitetet akomoduese dhe shërbimet për ushqim dhe përgatitja e Raportit të VNMJ-së të domosdoshme për këtë nën-projekt. Në muajin janar të vitit 2016, raporti i VNMJ-së për këtë nën-projekt 3 është përgatitur nga Inspektori i mjedisit jetësor të komunës së Koçanit, znj. Leta Georgieva dhe është miratuar nga Kryetari i komunës së Probishtipit z.Toni Tonevski me Aktvendim UPI nr. 25-2 nga data 15.01.2016 (Aneksi 4).

Të gjitha raportet e VNMJ-së janë përgatitur në përputhje me rregulloren nacionale dhe përmbajnë përshkrimin e objektivave kryesore të projektit, aktivitetet kryesore të nën-projektit, fotografitë nga lokacionet ku do të kryhen aktivitetet e nën-projektit dhe masat e përgjithshme për përmirësimin e mjedisit jetësor.

Legjislacioni nacional relevant për projektin (gjatë ndërtimit / rikonstruimit dhe fazës operative):

- o Ligji për mjedisin jetësor (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 53/05, 81/05, 24/07, 159/08, 83/09, 124/10, 51/11, 123/12, 93/13, 187/13, 42/14, 44/15, 129/15, 192/15 dh 39/16);
- o Rregullore për aktivitetet për të cilat duhet përgatitur elaborat me Raportin mbi VNMJ-në dhe duhet të miratohet nga Kryetari i komunës ose Kryetari i Qytetit të Shkupit ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 80/09, 32/12)
- o Rregullore për formën dhe përmbajtjen e Raportit të VNMJ-së në përputhje me llojet e aktiviteteve ose aktivitetet për të cilat është përgatitur Raporti i VNMJ-së, si dhe në përputhje me ofruesit e aktiviteteve dhe përfshirjen e aktiviteteve dhe aktiviteteve nga personat fizik dhe juridik, miratimi i tyre, si dhe mënyra e mbajtjes së regjistrit të raporteve të miratuara ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 44/13, 111/14);
- o Ligji për ujërat (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 87/08, 6/09, 161/09, 83/10, 51/11, 44/12, 163/13, 180/14, 146/15);
- o Rregullore për klasifikimin e ujërave (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 18/99);
- o Rregullore për kategorizimin e rrjedhave ujore, liqeneve, akumulimeve dhe ujërave nëntokësore (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 18/99, 71/99);
- o Ligji për mbeturinat (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 68/04, 71/04, 107/07, 102/08, 134/08, 124/10, 51/11, 123/12, 147/13, 163/13 , 51/15, 146/15, 192/15);
- o Lista e llojeve të mbeturinave (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 100/05);
- o Ligji për ambalazhimin e mbeturinave (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 161/09, 06/09, 17/11, 47/11, 136/11, 6/12, 39/12, 163/13, 146/15);
- o Rregullore për procedurat dhe mënyrën e grumbullimit, transportimit, përpunimit, magazinimit, trajtimit dhe mënjanimin e mbetjeve të vajrave si dhe mënyrën e mbajtjes së evidencës dhe dorëzimit të të dhënave (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 156/07);
- o Rregullore për rregullat e përgjithshme për trajtimin e mbeturinave komunale dhe atyre jo të rrezikshme (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 147/07);
- o Rregullorja për kushtet e detajuara për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme, si dhe mënyrën e ambalazhimit dhe etiketimit (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 15/08);
- o Ligji për mbrojtjen e natyrës (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 67/04, 14/06, 84/07, 35/10, 47/11, 148/11, 59/12, 13/13, 163/13, 41/14, 146/15)
- o Ligji për pyjet (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 64/09, 24/11, 54/11, 25/13, 79/13, 147/13, 43/14, 160/14 dhe 44/15);

- o Listat për përcaktimin e specieve të egra të mbrojtura dhe të mbrojtura në mënyrë rigoroze (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 139/11);
- o Ligji për mbrojtjen nga zhurma ("Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 79/07, 124/10, 47/11, 163/13, 146/15)
- o Rregullore për indikatorët e zhurmës dhe zona e zbatimit të indikatorëve shtesë të zhurmës (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 107/08);
- o Rregullore për nivelin e lejuar të zhurmës në mjedisin jetësor (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 147/08);
- o Rregullore për vendndodhjen e stacioneve matëse dhe vendeve matëse (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 120/08);
- o Ligji për cilësinë e ajrit të ambientit (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 67/04 me amendamente nr. 92/07, 35/10, 47/11, 59/12, 163/13, 10/15, 146/15);
- o Rregullore për vlerat kufitare të niveleve dhe llojeve të substancave ndotëse në ajrin e ambientit dhe pragjet e alarmit, afati për arritjen e vlerave kufitare, margjinat e tolerancës së vlerës kufitare, vlerat e synimeve dhe objektivat afatgjate (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 19/05);
- o Ligji për mbrojtje dhe shpëtim ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 36/04, 49/04, 86/08, 124/10 dhe 18/11);
- o Ligji për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 20/04, 71/04, 115/07, 18/11, 148/11, 23/13, 137/13, 164/13, 38/14, 44/14, 199/14, 154/15);
- o Ligji për shëndetësi dhe siguri në punë (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 92/07, 98/10, 93/11, 136/11, 60/12, 23/13, 25/13, 137/13, 164/13, 158/14, 15/15 dhe 129/15);
- o Ligji për mbrojtjen e shëndetit (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 43/12, 145/12, 87/13, 164/13, 39/14, 43/14, 132/14, 188/14, 10/15, 61/15)
- o Rregullore për kërkesat minimale për sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 154/2008);
- o Rregullore për pajisjet mbrojtëse personale të përdorura nga punëtorët në punë (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 92/07);
- o Rregullore për sigurinë dhe shëndetin gjatë punës për punëtorët e ekspozuar në rrezik të zhurmës (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 21/2008);
- o Ligji për rrugët publike (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 84/08, 52/09, 114/09, 124/10, 23/11, 53/11, 44/12, 168/12, 163/13, 187/13, 39/14, 42/14, 166/14, 44/15, 116/15, 150/15, 31/16 dhe 71/16)
- o Ligji për planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 51/05, ndryshime 137/07 dhe 24/08, teksti i spastruar, 91/09, ndryshime 124/10, 53/2011, 144/12 dhe 70/13, 163/13, 42/14, 44/15, 193/15 dhe 31/16)
- o Rregullore për standardet dhe normat e planifikimit hapësinor (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 69/99)

PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Nën-projekti 1: Ndërtimi, rikonstruimi dhe përmirësimi i shtigjeve malore të çiklizmit në malet e Osogovës (Ponikva - liqeni Gratçe - Koçani) – me gjatësi të përgjithshme prej 35 km.

Nën-projekti përfshin ndërtimin, rikonstruimin dhe përmirësimin e shtigjeve ekzistuese të çiklizmit në malet e Osogovës (Ponikva-liqeni Gratçe-Koçan) - në gjatësi të përgjithshme prej 35 km. Në përgjithësi, aktivitetet e projektit që do të kryhen përgjatë shtigjeve të malit Osogovë do të përfshijnë:

- Punë përgatitore - përcaktimi dhe sigurimi i linjës të shtegut; largimi i vegjetacionit të ulët (vegjetacioni i ulët deri në 40 cm); heqja e pllakave ekzistuese të betonit (vetëm në shtegun nga Hotel Gratçe deri në kurorën e liqenit Gratçe);
- Punimet e ndërtimit - gërmimi i tokës; vendosja e materialit nga guri i thyer; shtrimi me pllaka blloku, ndërtimi i shkallëve nga betoni ndërmjet 503.23 – 510.27 m nga linja (vetëm në shtegun nga Hotel Gratçe deri në kurorën e liqenit Gratçe); inkorporimi i pajisjeve urbane përgjatë shtigjeve (tabelat informuese, ulëset, koshi i mbeturinave, ulëse për soditje peizazhi, etj.); punime të betonit të armuar (përforcim, prerje, lakim, lidhje dhe montim të armaturës, vendosja e betonit MB30, etj.) gjatë inkorporimit të pajisjeve urbane përgjatë pothuajse të gjitha shtigjeve etj;
- pastrimi i vendit të ndërtimit nga mbetjet e krijuara;

Përshkrim i hollësishëm i aktiviteteve të planifikuara për secilin shteg (lokacioni i projektit) do të përfshijë këto punime:


1. Shtegu i çiklizmit të Koçanit (vendbanimi Baçalluk) deri në liqenin Gratçe në gjatësi të përgjithshme prej 2801.44 m - Ndërhryjet e planifikuara përfshijnë: përcaktimin e linjës ekzistuese, pastrimin e vegjetacionit përgjatë shtegjeve (deri në 40 centimetra dhe jo jashtë shtigjeve), gjerësia e shtegut nuk do të ndryshojë, gërmimet e tokës, vendosja e materialit nga guri i grimcuar, aktivitetet me beton të armuar (përforcim, prerje, lakim, lidhje dhe montim të armaturës, vendosje e betonit MB30 etj) gjatë inkorporimit të pajisjeve urbane (tabelat informuese (2), udhërrëfyes (6), pushimore (4), ulëse (8) koshe për mbeturina (12) ulëse për soditje peizazhi (2), etj).
2. Shtegu për këmbësorë dhe për çiklizëm nga Hoteli Gratçe deri në kurorën e liqenit Gratçe në gjatësi të përgjithshme prej 520.81 m, - Ndërhryjet e planifikuara përfshijnë: përcaktimin e linjës ekzistuese, pastrimin e vegjetacionit përgjatë shtigjeve (deri në 40 cm dhe jo jashtë shtigjeve) gjerësia e shtegut nuk do të ndryshojë, gërmimet e tokës, vendosja e materialit nga guri i grimcuar, aktivitetet me beton të armuar (përforcim, prerje, heqje e betonit (265 m³ pllaka betoni), lakimi, lidhje dhe montim të armaturës, vendosje e betonit MB30, etj) gjatë inkorporimit të pajisjeve urbane (tabela informuese (2), ulëse, (2) koshe për mbeturina (2), etj), ndërtimi i shkallëve (ndërmjet 503.23 – 510.27m nga linja), shtrimi me pllaka (bekatoni) me një shtresë 6 cm;
3. Shtegu i çiklizmit Jastrebnik (liqeni Gratçe QSR - Ponikva) me gjatësi të përgjithshme prej 15.21 km - Ndërhryjet e planifikuara përfshijnë: përcaktimin e linjës ekzistuese, pastrimin e vegjetacionit përgjatë shtigjeve (deri në 40 centimetra dhe jo jashtë shtigjeve); gjerësia e shtegut nuk do të ndryshojë, gërmimet e tokës, punimet e betonit të armuar nuk janë planifikuar gjatë inkorporimit të pajisjeve urbane (tabela informuese (2), udhërrëfues (4), ulëse druri të mbuluara me kulm (7));
4. Shtegu i çiklizmit nga Ponikva deri në liqenin Gratçe në gjatësi të përgjithshme prej 14.973 km - Ndërhryjet e planifikuara përfshijnë: përcaktimin e linjës ekzistuese, pastrimin e

vegetacionit përgjatë shtigjeve (deri në 40 centimetra dhe jo jashtë shtigjeve), gjerësia e shtegut nuk do të ndryshojë, punimet e betonit të armuar nuk janë planifikuar gjatë inkorporimit të pajisjeve urbane (tabelat informuese (2), udhërrëfytes (4), ulëse druri të mbuluara me kulm (6) dhe koshe për mbeturina (6));

5. Shtegu i çiklizmit nga kurora e liqenit Gratçe deri tek ujëvarat në gjatësi prej 1.567 km. - Ndërhyrjet e planifikuara përfshijnë: përcaktimin e linëzistus ekzistuese, pastrimin e vegetacionit përgjatë shtigjeve (lartësi prej 40 cm dhe jo jashtë shtigjeve), gjerësia e shtegut nuk do të ndryshojë, gërmimi i tokës, vendosja e materialit prej guri të thyer, aktivitete me beton të armuar (përforcim, prerje, lakim, lidhje dhe montim, vendosja e betonit MB 30, etj) gjatë inkorporimit të pajisjeve urbane (tabela informuese (2) udhërrëfytes (6), pushimore (5) ulëse për soditje peizazhi (4), ulëse (10) koshe për mbeturina (15), vende për zgarë (5), etj). Vendosja e ulëseve për soditje peizazhi / pushimoreve të vogla përgjatë shtigjeve do të përfshijë:

- Largimin e dheut dhe gërmimin;
- Aktivitetet e betonit të armuar (përforcim, prerje, lakimi, lidhje dhe montim të armaturës, vendosja e betonit MB 30 në shtresë prej 20cm etj)

Vendosja e konstruksionit të drurit për ulëset e soditjes së peizazhit dhe pushimoreve (strehimore, tavolina, ulëse, etj). Ulëset për soditjet e peizazhit do të ndërtohen nga druri i gdhendur me lartësi prej 3.55 m dhe me gjerësi prej 2.55 m. Midis shtyllave do të ndërtohen dy ulëse prej druri me mbështetëse, të përforcuara në shtyllat mbajtëse. Një tavolinë drejtkëndore prej druri 103/135cm me një lartësi prej 80cm do të vendoset në mes të vendit për soditje të peizazhit me lartësi prej 80 cm.



Ulëse për soditje peizazhi nga druri

Do të ndërtohen katër (4) ulëse për soditje të peizazhit do të ndërtohen në shtegun nga kurora e liqenit Gratçe deri në ujëvarat në pikat vijuese: 23-0 + 440.00; 24-0 + 460.00; 43-0 + 840.00; 65-1 + 280.00.

Ndërsa dy ulëse tjera për soditje peizazhi (2) do të ndërtohen në shtegun Bavçulluk - liqeni Gratçe në pikat vijuese: 84-1 + 560.00 dhe 93-1 + 840.00.

Pushimore gjashtëkëndore do të ndërtohen nga druri i gdhendur, me lartësi prej 4.33 metra. Shtyllat janë përpunuar prej druri të thatë 15/15/250 cm, të vendosura në formën e një gjashtëkëndëshi, në

distancë prej 218 cm, të vendosura në trarë druri 15/15 cm dhe të ankoruara në pllakën ekzistuese AB. Do të ndërtohet një mbulesë gjashtëkëndore prej druri në kulm me një anë 296 cm në lartësi prej 265 cm. Në mes të pushimores do të ndërtohen 6 stola prej druri me mbështetëse, të përforcuara me shtyllat mbajtëse. Në mes të pushimores, do të vendoset një tavolinë prej druri në formë gjashtëkëndëshi me lartësi prej 80 cm.



Pushimore gjashtëkëndore

Sipas projektit kryesor për shtigjet, në shtegun e parë (Bavçalluk - liqeni Gratçe) do të ndërtohen 4 pushimore në pikat e mëposhtme: 43-0 + 840.00; 48-0 + 940.00; 59-1 + 160.00; 120-2 + 20.00. Gjithashtu, në shtegun e pestë (nga kurora e liqenit Gratçe deri në ujëvarat), do të ndërtohen 5 pushimore në pikat vijuese: 12-0 + 220.00; 44-0 + 860.00; 70-1 + 380.00; 78-1 + 540.00.


Nuk do të ketë prerje drurësh.

Në përgjithësi, aktivitetet e projektit për ndërtim, rikonstruim dhe përmirësim të shtigjeve malore të çiklizmit malor në malin e Osogovës përfshijnë: përcaktimin e linjës ekzistuese dhe pastrimin e vegjetacionit përgjatë shtigjeve ku janë të nevojshme (rreth 21.000 m² për të gjitha shtigjet malore të çiklizmit, por vetëm vegjetacion të ulët deri më 40 centimetra, barë dhe rrënjë, nuk ka nevojë për prerjen e drunjve përgjatë shtigjeve), germimet e tokës dhe betonit, transportin e materialit të gërmuar për deponim të përkohshëm, vendosjen e gurit të thyer, inkorporimin e pajisjeve urbane (tabela informuese, koshe për mbeturina), vendosja e rekuizitave për fëmijë (për terrenin e lojërave), në shtegun nga Koçani (v.th. Baçalluk) deri në liqenin e Gratçes dhe punime nga betoni si përpunimi i shkallëve nga betoni në një pjesë të shtegut për çiklizëm dhe për këmbësorë nga Hoteli Gratçe deri në kurorën në liqenin Gratçe.

Aktivitetet ndërtimore (shtrimi i pllakave me bekaton) do të realizohen vetëm në shtegun nga Hoteli Gratçe deri në digën e liqenit Gratçe me gjatësi prej 521 m që sipas projektit bazë do të përfshijë:

- Rregullimi i tokës - përcaktimi dhe sigurimi i linjës së shtegut; largimi i vegjetacionit të ulët (vegjetacioni i ulët deri në 40 cm); heqja e pllakave ekzistuese prej betoni (265 m³); etj

- Punimet tokësore - gërmimi i tokës; vendosja e materialit prej guri të grimtuar në shtresa prej 25 dhe 5 cm; shtrimi me pllaka bekatoni prej 6 cm; etj
- Inkorporimi i pajisjeve urbane përgjatë shtegut (tabela informuese, ulëse, koshe për mbeturina, etj.).
- Punime betoni - ndërtimi i shkallëve nga betoni përgjatë linjës së shtegut (ndërmjet 503.23 – 510.27 m nga linja/).



Fotografia 1. Pamja e shtegut nga Hoteli Gratçe deri në digën e liqenit Gratçe 775m² (burimi: projekt kryesor për shtegun, Sivil inzhenering Shkup)

Rikonstruimi i shtigjeve të tjera malore të çiklizmit (gjatësia e përgjithme prej 34.643 metra) do të përfshijë: pastrimin e vegjetacionit përgjatë shtigjeve ekzistuese dhe instalimin të pajisjeve urbane nga lëndët e para natyrale lokale (druri): ulëse, ulëse për soditje peizazhi, tabela informuese, zona pushimi, koshe për mbeturina, terrene lojërash për fëmijë etj.).

Të gjitha shtigjet për këmbësorë, me përjashtim të shtegut nga Hotel Gratçe deri te diga Gratçe, janë parashikuar të jenë shtigje për këmbësorë dhe çiklizëm të pa shtruara me pllaka (vetëm rregullim, përcaktim dhe pastrim të shtigjeve ekzistuese pa asfaltim), pastrim përth tyre dhe largimi i vegjetacionit të ulët ekzistues (bari, rrënjët, shkurret, etj.). Nuk do të bëhet zgjerim i dukshëm i gjerësisë së tyre e as nuk do vendoset material nga guri i grimtuar.

Gjendja ekzistuese do të ruhet - shtigjet e pa asfaltuara për këmbësorë dhe të çiklizmit pa asfaltim / ndërtim i rrugëve. Të gjitha shtigjet malore të përmendura në malin Osogovë ekzistojnë dhe nuk

ka nevojë për drejtime të reja (Fotografia 2). Stabiliteti i tokës do të kontrollohet dhe do të sigurohet para fillimit të punës dhe nëse është e nevojshme, do të bëhen studime gjeoteknike.



Fotografia 2. Gjendja aktuale e shtigjeve ekzistuese malore të çiklizmit në Malet e Osogovës (Ponikva - liqeni Gradçe - Koçani)

Nën-projekti 2: Rikonstruimi i shtëpizës malore të Ponikvës, duke përfshirë edhe sigurimin e pajisjeve

Aktivitetet e projektit përfshijnë rikonstruimin / zgjerimin e shtëpizës malore të Ponikvës (nuk gjendet në zonën e mbrojtur) në tri nivele: bodrum, katin përdhese dhe pjesa e nënkulmit. Aktualisht, objekti ka këto dimensione: 7 m x 35 m. Brenda ndërtesës ka një dhomë që në të kaluarën është përdorur si klasë për ligjërata dhe trajnime për nxënësit. Muret janë prej guri prej 60 cm. Lartësia e ndërtesës është 2.6 m. Dyert dhe dritare janë prej druri dhe mjaft të dëmtuara. Konstruksioni i kulmit është prej druri me një çati prej qeramike.

Sipërfaqja e përgjithshme e shtëpizës malore do të jetë 490.54 m² (Fotografia 3). Nën-projekti në përgjithësi do të përfshijë aktivitetet e mëposhtme: rrënimi i pjesës së brendshme të ndërtesës ekzistuese (muret e brendshme), heqjen e konstruksionit të çatisë prej druri të mbuluar me qeramikë dhe ndërtimin e një kulmi të ri, konstruksion të ri me beton të armuar çeliku me ndërtimin e shtyllave të reja nga betoni të lidhura me muret ekzistuese nga guri, shkallë nga betoni i armuar që çojnë në tavan, gërmimi i podrumit dhe instalimin e energjisë elektrike, ujësjellësit dhe kanalizimit dhe ndriçimit me LED.

Veprimtaritë ndërtimore do të përfshijnë murimin, izolimin dhe punime qeramike, punim i fasadë, vendosjen e ngrohëses me peleta dhe aktivitete të tjera që lidhen me rikonstruimin e shtëpizës malore. Kulmi është i mbuluar me qeramide dhe nuk ka asbest në vend.

Shtëpiza malore e Ponikvës do të lidhet me rrjetin ekzistues komunal të furnizimit me ujë. Lidhja e furnizimit me ujë do të bëhet me gypa polipropileni me ø100mm. Shkarkimi i ujërave të zeza nga shtëpiza malore do të sigurohet nëpërmjet lidhjes me kanalizimin komunal. Kjo do të bëhet duke ndërtuar një sistem kanalizimi të brendshëm (me tubacione PVC ø50 mm - ø125mm) dhe pjesa e jashtme (me tubacion PVC me ø160 mm) brenda ndërtimit.

Për kryerjen e aktiviteteve të projektit do të shfrytëzohen këto pajisje:

- Ekskavator për gërryerje dhe ngarkim;
- Kamion për transportin e mbeturinave;
- Përzierësi me pompë për futjen e betonit;
- Pajisjet për punimet e ndërtimit (pajisje qarkore, skele).




Fotografia 3. Gjendja aktuale e shtëpizës malore në Ponikvë

Pronar i shtëpizës malore është komuna e Koçanit (me vendim të komunave të Probishtipit dhe Koçanit, shtëpiza malore e Ponikvës, i takon komunës së Koçanit), e cila ka marrë lejen e ndërtimit. Në shtëpizën malore mund të arrihet lehtësisht përmes rrugës ekzistuese që kalon afër shtëpizës (terreni rreth malit është i sheshtë dhe lehtësisht i arritshëm për mekanizim).

LOKACIONI I PROJEKTIT

Nën-projekti 1: Ndërtimi, rikonstruimi dhe përmirësimi i shtigjeve malore të çiklizmit në malet e Osogovës (Ponikva - liqeni Gratçe - Koçan) – me gjatësi të përgjithshme prej 35 km

Lokacioni i projektit për ndërtim, rikonstruim dhe përmirësim të shtigjeve malore të çiklizmit të maleve të Osogovës rreth akumulimit të Gratçes në një distancë prej 3 km nga Koçani dhe përfshin sipërfaqe nga liqeni Gratçe deri në lokalitetin turistik Ponikva.




Fotografia 4. Lokacioni i projektit "Shtigjet malore të çiklizmit në Malet e Osogovës" (Ponikva - diga Gratçe - Koçan)

Aktivitetet e propozuara të projektit janë të vendosura në zonën e mbrojtur të propozuar - Zonë e Mbrojtur "Malet e Osogovës", por kjo zonë e propozuar nuk është miratuar si zonë e mbrojtur. Nuk ka lloje dhe vendbanime të mbrojtura rreth lokacionit të projektit e as zona të ndjeshme.

Lokacioni i projektit përfshin sipërfaqe me lartësi mbidetare prej 400 deri në 1500 metra mbi nivelin e detit. Duke filluar nga pika më e ulët e lartësisë mbidetare (400 deri në 1500 m), përgjatë lokacionit të projektit, mund të gjenden habitatet e vegjetacionit të ulët pyjor, siç janë: *Corylus avellana*, (Lajthi - Statusi i IUCN: Shqetësimi më i vogël), *Carpinus betulis* (shkoza - Statusi i IUCN: Shqetësimi më i vogël), *Fraxinus excelsior* (frashër i zi) dhe *Quercus petraea* (bungu). Mbi këtë zonë pyjore, si përfaqësues i vendbanimit pyjor shfaqet ahu (*Fagus sylvatica*).

Në pikën më të lartë mbidetare të lokacionit të projektit, në sipërfaqe të vogla mund të gjenden halorë që përfaqësohen nga këto lloje: *Pinus sylvestris* (Pisha e bardhë - Statusi IUCN: Shqetësimi më i vogël) *Pinus nigra* (pisha e zezë - Statusi IUCN: Shqetësimi më i vogël), *Abies alba* (Bredhi i bardhë - Statusi IUCN: Shqetësim më i vogël) dhe *Juniperus communis* (Dëllinja - Statusi IUCN: Shqetësim më i vogël).

Shpërndarja e vegjetacionit pyjor brenda Maleve të Osogovës dhe vegjetacioni që mund të gjendet në lokacionet e projektit është paraqitur në fotografinë e mëposhtme.



Burimi: Studimi për valorizimin e zonës së mbrojtur të maleve të Osogovës
Fotografia 5. Bashkësia e pyjeve në zonën Osogovë

Të gjitha shtigjet tashmë ekzistojnë dhe nuk ka nevojë për prerjen e drujve (vetëm pastrimin e tyre nga vegjetacioni i ulët deri në 40 cm)

Vendi ku do të kryhen aktivitetet e projektit është kryesisht i pabanuar, në pronësi të Republikës së Maqedonisë. Përreth shtigjeve të çiklizmit ka vetëm disa shtëpi pushimi në distancë prej rreth 500 metra nga shtegu i tretë (fshatrat malore Jastrebnik dhe Çurillak, të cilat janë fshatra të shpërndara) dhe në shtegun e katërt (Jastrebnik - Gratçe) ka rreth 10-15 shtëpi në fshatin Leshki (200 metra nga shtegu).



Fshati Jastrebnik



Lokaliteti Ponikva

Në lokalitetin e Ponikvës gjenden shtëpi pushimi, qendrat e skijimit, bungalot, terrenet sportive dhe rekreative, hotelet dhe të ngjashme. Lokaliteti Ponikva ndodhet 20 km në veri të Koçanit në Malet e Osogovës në 1580 metra lartësi mbidetare, i cili është një vend i jashtëzakonshëm për zhvillimin e turizmit veror dhe dimëror. Në Ponikvë ekziston vendpushimore me 82 shtretër, shtigje skijimi, dy teleferikë, një lagje për fundjavë, restorante, motele ndërsa atraksion të veçantë ofron nga rezervati i gjuetisë "Osogovë" i pasur me gjahtë egër siç janë dreri dhe derri i egër.

Të gjitha shtigjet ekzistojnë dhe nuk do të ketë prerje të drunjve. Vetëm pastrimi i vegjetacionit të ulët (maksimumi deri në 40 cm) kur është e nevojshme përgjatë shtigjeve.

Shtegu i parë i çiklizmit kalon nga pjesa perëndimore e lumit Koçanska. Fillon nga parkingu tokësor i vendosur në rrugën Koçan - kurora e liqenit Gradçe. Shtegu i dytë i çiklizmit fillon nga Hoteli Gratçe dhe përfundon në afërsi të kurorës së liqenit Gratçe. Shtegu i tretë fillon nga diga e Gratçes, kalon nëpër dy fshatra malore Çurilak dhe Jastrebnik. Shkolla e vjetër është përshtatur në Qendër për Valorizim të Trashëgimisë Kulturore dhe ndodhet në fshatin Jastrebnik. Ky shteg përfundon në QRS Ponikva. Shtegu i katërt fillon nga fshati Jastrebnik dhe përfundon në digën Gratçe, ndërsa shtegu i fundit fillon nga diga Gratçe, ndjek bregun e liqenit dhe përfundon në ujëvarat.

Gjatësia e përgjithshme e shtigjeve të çiklizmit është 35 km me gjerësi prej 1.5 deri në 2 m. Lokacionet e 5-së shtigjeve malore të çiklizmit janë paraqitur në Fotografinë e 6.



- Legend:
- | | | |
|---|--------------------------------|--|
| 1 | Mount bike trail of 2.801,44 m | Kochani (settlement Bachchaluk) to Lake Gradce in the length of 2.801,44 m |
| 2 | Mount bike trail of 520,81 m | Hotel Gradce to the crown of the dam Gradce in length of 520,81 m |
| 3 | Mount bike trail of 15,21 km | Jastrebnik (Lake Gardce - SRC Ponikva) in length of 15,21 km |
| 4 | Mount bike trail of 14,973 km | Ponikva to the dam Gradče in length of 14,973 km |
| 5 | Mount bike trail of 1,567 km | the crown to the dam Gradce to the waterfalls in the length of 1,567 km |

Fotografia 6. Lokacioni i nën-projekteve të shtigjeve për

këmbësorë dhe çiklizmit

Nën-projekti 2: Rikonstruimi i shtëpizës malore të Ponikvës, duke përfshirë edhe sigurimin e pajisjeve

Shtëpiza malore e Ponikvës është e vendosur në parcelën kadastrale 332/442 në komunën kadastrale Jamniste (komuna e Probishtipit) në QRS Ponikva. Pronari i shtëpizës malore është komuna e Koçanit (me vendim të komunave: Probishtip dhe Koçan, shtëpiza malore e Ponikvës i takon komunës së Koçanit), e cila ka marrë leje ndërtimi. Toka përreth malit është në pronësi të Republikës së Maqedonisë.

Shtëpiza malore e Ponikvës nuk është e mbrojtur si një trashëgimi historike ose kulturore.

Ndërtesa është e vendosur në terren të pjerrët nga verilindja në jugperëndim. Qasja në objekt bëhet nëpërmjet shtigjeve për këmbësorë që lidhen me rrugën ekzistuese të asfaltuar Koçan - Ponikvë.

Në afërsi të shtëpizës malore të Ponikvës ndodhen kapacitetet turistike. Disa prej tyre janë rinovuar, ndërsa të tjerët janë shkatërruar dhe nuk punojnë. Fotografia 7 tregon lokacionin e shtëpizës malore të Ponikvës.



Fotografia 7. Lokacioni i shtëpizës malore të Ponikvës

Fotografi nga brenda dhe jashtë e shtëpizës malore Ponikva janë dhënë në Fotografinë 8.




Fotografia 8. Fotografi nga brenda dhe jashtë shtëpizës malore Ponikva

GJEOLIGJIA

Gjeologjikisht, pjesa lindore e Maqedonisë, duke përfshirë rajonin e Koçanit (gryka e lumit Bregalnica), i përket sistemit të Rodopit (masivit serbo – maqedonas) që përbëhet nga rreshtet kristaline dhe graniti. Formimi i këtyre maleve ndodhi në paleozoik, me gabime të formuara më vonë në terciar. Sot, pellgu karakterizohet nga një strukturë e llojllojshme relievi, që përbëhet nga zona malore me lugina dhe kodrina të sheshta.

Aspekti i formacioneve gjeologjike për komunën e Koçanit përmban gurët metamorfikë para-Kambrian, sedimentet metamorfike paleozoike dhe shkëmbinj të vullkanik terciar dhe sedimentet kuaternare. Depozitat aluviale përfaqësohen nga gurët e zhavorrit, rërës dhe muskositës dhe ndodhen përgjatë rrjedhës së lumit Bregalnica.



Burimi: Plani hapësinor i rajonit të planifikuar lindor të Republikës së Maqedonisë

Fotografia 9. Niveli i erozionit në lokacionet e projekteve në rajonin e planifikimit lindor në RM

HIDROLOGJIA

Terreni rreth shtigjeve malore të çiklizmit është kodrinore malore, zona është e dobët me akuifere. Varfëria me burime, rrjedha të shkurtra dhe të vogla dhe rrjedha ekspresive mbulon komunën midis zonave të varfra hidrologjike në Republikën e Maqedonisë. Potenciali më i madh ujqor në rajon është lumi Bregalnica, i cili i mbledh të gjitha lumenjtë e vegjël rreth tij. Në afërsi të shtigjeve kalon lumi Koçanska si dhe lumi i Vogël dhe lumi i Madh.

PËRSHKRIMI I BIODIVERSITETIT NË MJEDISIN E NËN-PROJEKTEVE

Malet e Osogovës, si dhe pjesa më e madhe e Maqedonisë lindore, bëjnë pjesë në rajonin biogeografik kontinental evropian, më saktësisht në krahinën e maleve të larta të Ballkanit. Sipas klasifikimit të zonave klimatike të vegjetacionit, zona e Ponikvës i përket zonës malore klimatike kontinentale (1.300 deri 1.650 m).

Përveç rrjedhës së lumit të Vogël nga shtegu Gratçe deri në Ponikva, zhvillohet komuniteti pyjor - Ass. Orno-quercetum petrae i përbërë nga bungu (*Quercus petraea*) dhe frashni i zi (*Fraxinus ornus*).

Shtegu në lartësitë më të ulta mbidetare kalon nëpër zonën e pyjeve të ulëta gjetherënëse (të nxehta, të thata). Relievi përbëhet nga shpatet e buta të pjerrëta, por gjithashtu edhe me shpate shumë të pjerrëta. Karakteristikë janë tokat pyjore ngjyrë kafe dhe kanelle dhe në substratin e silikatit si dhe litosole, regosole dhe gurore. Ky gjendet takohet në një lartësi midis 700 dhe 1000 lartësi mbidetare.

Vegjetacioni potencial perfaqesohet nga pyje termofilike të shkozës dhe dushkut, pyjet e sheshta me lisa dhe nga shkoza e zezë në shpatet jugore. Në shpatet veriore nuk janë të pranishme pyje nga shkoza dhe dushku, ndërsa në lugina gjendet ahu podgorik (*Festuco heterophylae*Fagetum). Matrica përbëhet nga pyje, kryesisht me shkoza dhe dushku sub-mesdhetar dhe pyjet e sheshta me lisa. Në mesin e tyre gjenden shumë livadhe të braktisura.



Fotografia 10 Zona e pyjeve të ulëta gjetherënëse

Komunitetet bimore të zonës alpine dhe subalpine *Thymo Poetumviolaceae*, *JasioniFestucetumsupinae* dhe *LinoSeslerietum* rriten nën-thellësitë e silikateve dhe toën acidike dhe përfshijnë sipërfaqe të mëdha rreth Ponikvës.

Llojet bimore karakteristike janë: *Fagus sylvatica*, *Fraxinus excelsior*, *Carpinus betulus* (IUCN Cmamyc: Shqetësimi më i vogël), *Corylusavellana* (IUCN Cmamyc: Shqetësimi më i vogël.), *Quercuspetraea*, *Berberis vulgaris*, *Sorbusaucuparia* (IUCN Cmamyc: Të rrezikuara), *Evonymuseuropaea*, *Acer campestre*, *Acer pseudoplatanus*, *Sorbustorminalis*, *Tiliaplatyphyllos* (IUCN Cmamyc: Shqetësimi më i vogël), *Ligustrumvulgare*, *Prunuscerasu*, *Prunusspinose* (Statusi IUCN: Shqetësimi më i vogël).

Peshqit: Nga peshqit në liqenin Gratçe janë regjistruar:

Rutilus rutilus Kar. (Statusi i IUCN: Shqetësimi më i vogël), *Rutilus macedonicus* Steind., *Leuciscus cephalus vardarensis*, Kar., *Chondrostoma nasus vardarensis* Kar., *Barbus barbus*

macedonicus Kar., *Barbus meridionalis petenyi* Heck., *Gobio gobio* L. (IUCN Status: *Albionus alburnus macedonicus* Kar (Statusi IUCN: i rrezikuar në mënyrë kritike A3c; B1ab (i, ii, iii) + 2ab (i, ii, iii), *Vimba vimba melanops* Heck., *Cyprinus carpio* L. (Statusi IUCN: i rrezikuar A2c), dhe *Carassius auratus gibelio* Bloch.

Krapi i zakonshëm (*Cyprinus carpio*) konsiderohet i rrezikuar (VU) mbrohet si specie strikte e mbrojtur (sipas Listës për përcaktimin e specieve të egra të mbrojtura dhe të mbrojtura në mënyrë rigoroze - Lista 1 (Gazeta Zyrtare nr.139 / 11) ndërsa *Alburnus alburnus macedonicus*) është një specie në mënyrë kritike e rrezikuar sipas listës së kuqe globale të IUCN.

Ihtiofauna në lumin Koçanska

Ihtiofauna në lumin Koçanska përfaqësohet në disa lloje siç janë: *Rutilus macedonicus* Steind. (Trofta maqedonase - Statusi IUCN: Mungesë e të dhënave – nevojitet përditësim), *Leuciscus cephalus vardarensis* Kar. (Chubs evropian), *Chondrostomus vardarensis* Kar. (Emër i përbashkët, Statusi IUCN: Pothuajse në zhdukje – nevojitet përditësim), *Barbus barbus macedonicus* Kar (IUCN Statusi: Mungesë e të dhënave - nevojitet përditësimi), *Gobio gobio* L. (Gudgeon, Statusi IUCN: Shqetësimi më i vogël) dhe *Vimba melanops* Heck. (Malamida Statusi IUCN: Mungesë e të dhënave - nevojitet përditësim). Informacioni për diversitetin e peshqive në lumin Kocanska janë marrë nga Studimi për diversitetin biologjik nga zona e propozuar e mbrojtur - propozimi "Malet e Osogovës".

Amfibët dhe reptilët: Në pjesët më të larta të maleve (1300 -1800 lartësi mbidetare) me pyjet e ahut gjenden këto lloje: *Lissotriton vulgaris* (IUCN Statusi: Shqetësimi më i vogël), *Salamandra salamandra* (IUCN Statusi: Shqetësimi më i vogël), *Bombina variegata* (IUCN Statusi: Shqetësimi më i vogël), *Rana graeca* (IUCN Statusi: Shqetësimi më i vogël), *R. temporaria*. (IUCN Statusi: Shqetësimi më i vogël), *Bufo viridis*, *Pseudepidax* dhe *Testudo graeca* (IUCN Statusi: I rrezikuar Vulnerability A1cd). Nga herptofauna sit ë rralla u u veçuan këto tri lloje në malet e Osogovës : *Zootocavivipara* (IUCN Statusi: shqetësimi më i vogël), *Typhlops vermicularis* (IUCN Statusi: shqetësimi më i vogël), dhe *Eryx jaculus*.

Shpendët: Zona më të rëndësishme për diversitetin e shpendëve është rajoni më i gjerë i Ratkova Skalës (nga Lumi Zletovska deri në Sinkovicë dhe Ponikvë). Ky lokalitet është shumë i rëndësishëm për praninë e llojeve të rëndësishme të shpendëve si kali i qyqes (*Neophron percnopterus*, Statusi IUCN: i rrezikuar A2bcde + 3bcde), dhe pastaj lloje të rralla të shpendëve, siç është lejleku i zi (*Ciconia nigra*, Statusi IUCN: Shqetësimi më i vogël).

Ky lokalitet (në distancë prej rreth 5 km nga Ponikva) ka rëndësi të jashtëzakonshme për shkak të prezencës së llojeve të shpendëve të rrezikuara globalisht si të rëndësishme ndërkombëtare, si për shembull skifteri i mesdheut (*Falco biarmicus*, Statusi i IUCN: Shqetësimi më i vogël) dhe Skifteri peregrine (*Falco peregrinus*, Statusi IUCN : Shqetësimi më i vogël). Çafka e përhimtë (*Ardeacinerea*, Statusi IUCN: Shqetësimi më i vogël) mund të vërehet shpesh në zonën bregdetare të liqenit të Koçanit, që ndodhet në ujërat më të ulëta të vendit.

Duke pasur parasysh skifterët dhe grabitçarë janë shumë të rralla dhe një kategori e rrezikuar në Republikën e Maqedonisë, me legjislacionin nacional për mbrojtjen e natyrës janë specie të mbrojtura në të gjithë territorin (Listat për përcaktimin e specieve të egra të mbrojtura dhe të mbrojtura në mënyrë rigoroze (Gazeta Zyrtare nr. 139/11)).

Gjitarët: Llojet më të zakonshme të gjitarëve të mëdhenj në vend janë ujku, dhelpra, baldosa, kunadhja gushëbardhë, qelbësi i zakonshëm, bukla e vogël dhe derri i egër, kaprolli dhe lepuri. Pranë Ponikvës mund të gjendet lakuriqi i madh (*Rhinolophus ferrumequinum*, Statusi IUCN: Shqetësim i vogël) që kategorizohet si specie afër rrezikut sipas Listës së Kuqe Evropiane të llojeve të rrezikuara..

Kërpurdhat: Llojet më të rëndësishme janë si më poshtë: *Agaricus campestris*, *A.macrosporus*, *Amanita rubescens*, *Armillaria mellea*, *Boletus aestivalis*, *B.edulis*, *Bovista plumbea*, *Cantharellus cibarius*, *Diatrype disciformis*, *Diatrype stigma*, *Laccaria laccata*, *Lactarius piperatus*, *Lepista nuda*, *Lycoperdon perlatum*, *Marasmius oreades*, *Mycena pura*..

Pilivesat e shpejta: Përveç lumit të Vogël dhe lumit të Madh që rrjedhin në afërsi të shtegut të liqenit Gradçe - Ponikva (shtegu tashmë ekzistues, ku nuk ka nevojë të mënjanohet vegjetacioni ekzistues), mund të gjendet *Caliaeschna microstigma* (Statusi IUCN: Shqetësimi më i vogël). Prania e *Ophiogomphus cecilia* (Statusi IUCN: Shqetësim më i vogël) dhe *Cordulegaster heros* (Statusi IUCN: Pothuajse i rrezikuar) tregon habitatet bregdetare ende të ruajtura mirë nga bimësisë bregore.

Cordulegaster heros është pothuajse lloj i rrezikuar (NT)

Fluturat: Në këtë vendbanim, më së shpeshti mund të gjenden këto lloje: *Anthocharis cardamines*, *Maniola jurtina*, *Melanargia galathea*, *Pararge aegeria*, *Apanthopus hyperantus*, *Coenonympha pamphilus*, *Leptidea sinapis*, *Vanessa atalanta*, *Thymelicus sylvestris*. Ndërsa fluturat më të rëndësishme që mund ti hasim janë: *Minois dryas*, *Phengaris arion* (IUCN Cmamyc: Rrezik i ulët / pothuajse i rrezikuar), *Plebejus sephirus*, *Euphydryas aurinia* dhe të tjera.

Insektet: Specie dominante janë *Carabus convexus dilatatus*, *Carabuscoriaceus cerisyi*, *Harpalus rubripes*, *Laemostenus punctatus* dhe *Notiophilus substriatus*. Të gjitha llojet janë të përhapura në Evropë ose në Ballkan.

